



CAMERA DI COMMERCIO
ITALIANA IN ALBANIA
CAMERE DI COMMERCIO ITALIANE ALL'ESTERO



1715/3
16.6.25

Tiranë, më 13.06.2025

DREJTUAR: Entit Rregullator të Energjisë
Z. Petrit Ahmeti ✓
Kryetar i Bordit të ERE

Për dijëni: Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Besjan Kadiu
Drejtor i Përgjithshëm

Furnizuesit të Tregut të Lirë (FTL)
Z. Albi Gjenerali
Administrator

LËNDA: Propozime nga Shoqatat e Biznesit në lidhje me ndryshimet në kontratën e shitblerjes së energjisë, "Në lidhje me vendimin e ERE-s për ndryshime në kontratën e PP me FTL sipas propozimit të bërë nga FTL".

Të nderuar,

Në vijim të Publikimit dhe Njoftimit në lidhje me vendimin e ERE-s për ndryshime në kontratën e PP me FTL sipas propozimit të bërë nga FTL" sipas vendimit 302/2024 të ERE-s dhe vendimit nr. 37, datë 10.02.2025 "Mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të bordit të ERE nr. 302 datë 30.12.2024" dhe seancës dëgjimore më datë 22.05.2025, ju lutemi gjeni bashkëngjitur propozimet e organizatave tona në lidhje me propozimet e FTL dhe të pranuar për t'u shqyrtuar nga ERE.

Vlerësojmë që këto ndryshime bëhen me qëllim, përmirësimin e komunikimit midis PP dhe FTL, si udhëheqëse e grupit të balancimit, me qëllim uljen fizike të disbalancave.

Në këtë frymë sugjerojmë që kontrata të parashikojë edhe dërgimin e informacionit prodhuesve për energjinë orare (në të ardhmen 15 min) të prodhuar në D+1 në mënyrë që prodhuesit të krijojnë një database të saktë si bazë për një analizë dhe parashikim sa më të saktë të prodhimit dhe të mund të identifikohen në kohë, të gjitha ndërprerjet në rrjet.

AREA - Rr. e Elbasanit Vila nr. 71, Tirane, Email: info@areasso.org

FIAA - Rr. "Themistokli Gërmenji", Pall Nr. 8, Kati2, Ap. No 9 Tirane, Email: contact@fiaalbania.al

CCIA - Sheshi "Skenderbej", Pallati i Kultures, Tirane, Email: segreteria@ccia.al

Confindustria Albania - Rr. :Themistokli Gërmenji", Pall. Frashëri, shk. 1, ap.12, Tirane; Email: info@confindustriaalbania.it



Pra, në koherencë edhe me pikën 4 të propozuar të kontratës theksojmë se, kjo kontratë do të konsiderohet e drejtë për palët dhe plotësisht funksionale vetëm pas certifikimit me anë të informimit elektronik nga ana e operatorëve të rrjetit të të gjitha ndërprerjeve në rrjet (orën dhe kohëzgjatjen e tyre) dhe kërkesave për kufizim të energjisë së prodhuar (orën dhe kohëzgjatjen) gjatë operimit normal të centraleve dhe dërgimin e këtij informacioni për energjinë e prodhuar në ditën D në ditën D+1 në adresë PP dhe FTL me qëllim diferencimin e tyre nga disbalancat dhe disbursimin e PP për energjinë e munguar.

Gjithashtu, ky proces të shoqërohet me moskonsiderimin e ndërprerjeve në rrjet si disbalanca dhe të rregullohet nga ERE disbursimi i PP për energjinë e humbur gjatë ndërprerjeve në rrjet gjatë operimit normal të centraleve.

Gjejmë rastin të përsërisim kërkesën që të fillohet procesi i ndryshimit të rregullave të tregut balancimit në përputhje me standartet bashkëkohore të propozuara në shkresën e dërguar më datë 26 Shkurt 2025 në lidhje me analizën e procesit dry-run të nominimit 15min (*bashkëngjitur*).

Për gjithë sa më sipër, jemi të gatshëm të diskutojmë në një seancë dëgjimore të gjithë nenet e propozuara nga ne me të gjithë palët që bëjnë të mundur zbatimin me sukses të kontratës së shitblerjes së energjisë midis PP dhe FTL.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, shpresojmë në marrjen parasysh të kërkesës sonë.

Me konsideratë,

Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinoueshme (AREA)
Marsida Nuredini

Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA)
Marinela Jazoj

Dhoma e Tregtisë Italiane në Shqipëri (CCIA)
Alda Bakiri

Confindustria Albania - Shoqata e Industrialistëve Italianë në Shqipëri
Gerta Bilali

AREA - Rr. e Elbasanit Vila nr. 71, Tirane, Email: info@areasso.org

FIAA - Rr. "Themistokli Gërmenji", Pall Nr. 8, Kati2, Ap. No 9 Tirane, Email: contact@fiaalbania.al

CCIA - Sheshi "Skenderbej", Pallati i Kultures, Tirane, Email: segreteria@ccia.al

Confindustria Albania - Rr. :Themistokli Gërmenji", Pall. Frashëri, shk. 1, ap.12, Tirane; Email: info@confindustriaalbania.it

KONTRATË

PËR SHIT-BLERJE TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET FTL sh.a DHE PRODHUESVE ME PËRPARËSI TË ENERGJISË ELEKTRIKE

E lidhur sot më datë ____/____/2025, në Tiranë, ndërmjet;

Shoqërisë _____ me seli të shoqërisë në _____,
regjistruar në QKB me Vendimin NR. _____, datë _____ të Gjykatës së Rrethit
Gjyqësor Tiranë, me nr. NIPT –i _____, Tiranë, këtu e më poshtë e quajtur
“**Shitësi**”, përfaqësuar nga **Z.** _____;

dhe

Furnizuesi i Tregut Të Lirë FTL sh.a., Shoqëri Aksionare, regjistruar si person juridik në
Rregjistrin Tregtar të mbajtur pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me nr. NIPT-i
L81530029T me seli ne adresen: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H. 1, Kati i IV,
Njësia Administrative Nr. 7, 1023, Tirane, këtu e më poshtë e quajtur “**Blerësi**”, përfaqësuar
nga Zj. _____;

Duke qenë se:

Shoqëria _____, ka marrë me koncesion/ka privatizuar, HEC-in/et __, sipas marrëveshjes së
koncesionit/sipas kontratës së shitblerjes__;

Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate;

ERE me vendim të saj nr. __, datë __, ka licencuar Shoqërinë __ për prodhimin e Energjisë
Elektrike; nga HEC/et _____ siç
përcaktuar në licencën e dhënë nga ERE. []; **jemi dakort me ndryshimin**

FTL sh.a. i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë
elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë duhet të nënshkruajë një kontratë për blerjen
e Energjisë Elektrike me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike në zbatim të nenit 11,
pika 2 të VKM nr.244, date 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit
të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të
cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji
elektrike”, ndryshuar me anë të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, në nenin 11, pika 2 ku
sanksionohet “Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e

Formatted: Font color: Red

Formatted: Font color: Red

Formatted: Font color: Dark Red

FTL sh.a.	<p>kujdesin e tij/tyre. Defektet në paisjet ose materialet ose vonesat për ti bërë ato të disponueshme, konfliktet e punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkohet të konsiderohen nga Palët si Forcë Madhore, përveç rastit kur burojnë nga një rrethanë e lidhur me Forcën Madhore;</p> <p>-është personi juridik i licencuar përgjegjes për operimin sigurtë, të besueshëm, dhe të efektshëm të rrejtit të shpërndarjes duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes të shtrirë në një zonë të caktuar dhe kur është e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme të tjera e të siguruar aftësi afatgjatë të sistemit për të përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, në harmoni me mjedisin dhe eficensën e energjisë i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë në zbatim të nenit 11, pika 2 të VKM nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM Nr. 883, datë 27.12.2019;</p>
Prodhuesit me perparesi	<p>-janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të ligjit për energjitë e rinovueshme të energjisë elektrike;</p>
Kontrata	<p>-kjo kontratë e nënshkruar për shitblerjen e Energjisë Elektrike, e lidhur midis Prodhuesit me Përparësi të Energjisë (Shitësit) dhe FTL sh.a (Blerësit) si dhe çdo shtesë apo amendim që mund t'i bëhet asaj në të ardhmen me konsensusin e palëve pas miratimit të ERE;</p>
Ligj	<p>-Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; Ligji Nr.7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; ligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar;</p>
Matës	<p>-d.m.th. një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të Energjisë Elektrike;</p>
Muaji	<p>-do të thotë periudha kohore e cila fillon në orën 00.00 p.d. të dites së parë kalendarike të muajit dhe mbaron në orën 24.00 të ditës së fundit kalendarike të po atij muaji.</p>
Palë	<p>-Shitësi dhe Blerësi në këtë kontratë;</p>

3.5 Blerësi bie dakort që të pranojë sasi të tjera shtesë të Energjisë Elektrike nga ana e Shitësit, në rast të një prodhimi më të madh nga ky i fundit. Për këtë Shitësi duhet të bëjë njoftimet përkatëse për ti mundësuar Blerësit marrjen e Energjisë si dhe rregullimin e programit të tij.

3.6 Pavarësisht detyrimit që ka FTL për të blerë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar nga Shitësi, Shitësi ka të drejtë të shesë të gjithë ose pjesë të energjisë së prodhuar subjekteve të tjerë të ndryshëm nga FTL, në sasi të dhe mënyrat e zgjedhura nga vetë Shitësi. Grafiku i lëvrimit për energjinë që do të shitet në tregun e pa rregulluar do të jetë në bandë sipas profilit 00:00 – 24:00.

Neni 4 (Në kontratën ekzistuese ky nen titullohet “Dokumentacioni paraprak, Tensioni, Frekuenca”. ERE ka miratuar propozimin e FTL për ta emërtuar “Programet e Livrimit dhe Remontet”)

Programet e Livrimit dhe Remontet

4.1. Shitësi i vendos në dispozicion Blerësit parashikimet dhe programet e prodhimit në terma afatgjatë dhe afatshkurtër dhe siguron Blerësin që ato janë në përputhje me praktikat më të mira të industrisë dhe legjislacionin e zbatueshëm.

Commented [A1]: Të fshihet fraza “praktikat më të mira të industrisë”

4.2. Shitësi vendos në dispozicion të Blerësit parashikimet dhe programet e prodhimit si më poshtë:

- a) Jo më vonë se data 1 (një) Gusht (propozojmë datën 30 Tetor që përputhet me mbylljen e vitit hidrik) e vitit aktual, parashikimin vjetor me bazë mujore të prodhimit të energjisë elektrike për vitin pasardhës;
- b) Jo më vonë se 1 javë para fillimit të secilit muaj, parashikimin mujor të prodhimit të energjisë elektrike;
- c) Jo më vonë se çdo ditë të mërkurë të secilës javë, për javën pasardhëse, parashikimin javor të energjisë elektrike;

Commented [A2]: 30 (tridhjetë) Tetor

Shitësi, për çdo ndryshim nga parashikimet e mësipërme, duhet të njoftojë Blerësin në përputhje me Kodet e Rrjetit dhe rregullat përkatëse.

Commented [A3]: Të përcaktohet qartazi cilave prej kodeve u referohet, pasi për prodhuesit duhet të jetë vetëm Kodi i Matjes dhe të saktësohen cilat janë rregullat specifike.

4.3. Shitësi që ka përzgjedhur të jetë pjesë e grupit të balancimit duhet të deklarojë programim e prodhimit për çdo periudhë të shlyerjes së disbalancave, për ditën në avancë D-1 bazuar në Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike dhe kushtet e marrëveshjes së shërbimit të balancimit.

Miruar me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshuar me Vendimin nr.147 datë 30.09.2016 dhe Vendimin Nr.12, datë 23.01.2020.

6.8 Blerësi duhet të mbajë në impiantet/instalimet përkatëse të prodhimit të Energjisë Rregjistrin (manual) të leximit të Matësit, i cili duhet t'i vihet në dispozicion për inspektime/testime përfaqësuesve të autorizuar të Blerësit dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut që kanë akses ligjor.

6.9 Në cdo rast përfaqësuesit e autorizuar të FTL Sh.a, në bazë të Kodit të Matjes dhe me cilësinë e Blerësit të Energjisë mund të kryejnë konform legjislacionit në fuqi inspektime dhe testime të Sistemit të Matjes dhe sistemet e tyre të rregjistrimit. Punonjësi i impiantit përkatës do t'i vejë në dispozicion përfaqësuesve të FTL Sh.a rregjistrin e leximit të Matësit së Energjisë Elektrike dhe do t'i krijojë aksesin e nevojshëm për të kontrolluar Sistemin e Matjes.

6.1. Mbas instalimit të Sistemit të Matjes dhe rregjistrimit të të dhënave online, Shitësi është i detyruar të bëjë transmetimin e këtyre të dhënave sipas këtij sistemi, përveç rasteve të pamundësive teknike për montimin e sistemit on- line të matjes.

Neni 7 (ERE ka miratuar vetëm pikën 7.5 të këtij neni dhe i ka ndryshuar numërimin. Në kontratën ekzistuese ky nen është neni nr. 11 me të njëjtin titull "Çmimi"). Ndërsa neni 7 i kontratës ekzistuese i titulluar " Dokumentimi i Procesit të Livrimit/Pranimit dhe Matjes" është Zëvendësuar nga "Çmimi")

Çmimi

7.1. Blerësi paguan Shitësin për Energjinë Elektrike të blerë, me çmimin e përcaktuar dhe të miratuar nga ERE sipas legjislacionit në fuqi.

7.2. Çmimi i aplikueshem në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate është çmimi në fuqi i përcaktuar dhe miratuar nga ERE.

7.3. Në se ERE miraton një çmim të ndryshëm nga ai i aplikuar sipas paragrafit 11.2, Palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme për sasinë e faturuara në përputhje me vendimin përkatës të ERE-s.

7.4. ERE përcakton dhe miraton me vendim brenda vitit aktual, çmimin e shitjes së energjisë për vitin pasardhës. Nëse çmimi vjetor miratohet më vonë se fillimi i vitit pasardhës, ky çmim do të jetë i zbatueshem që nga data 1 Janar i vitit pasardhës dhe palët do të bëjnë korrigjimet e nevojshme në faturat përkatëse për sasinë e lëvruara dhe të faturuara para miratimit të çmimit, në përputhje me vendimin përkatës të ERE.

7.5. Për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, Blerësi paguan Shitësin, me çmimin e përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi, në momentin e lidhjes së kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (.....), metodologjisë për përcaktimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga

Miratur me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshuar me Vendimin nr.147 datë 30.09.2016 dhe Vendimin Nr.12, datë 23.01.2020.

13.1. Palët kanë të drejtë të përfundojnë Kontratën në qoftë se reciprokisht bien dakord për këtë gjë. Palët njoftojnë ERE brenda 5 ditësh për përfundimin e Kontratës.

13.2. Palët kanë të drejtë të zgjidhin Kontratën në çdo kohë nëpërmjet njoftimit me shkrim të palës tjetër nëse një ngjarje jashtë kontrollit të arsyeshëm e pengon palën e prekur që të përmbush detyrimet e kësaj Kontrate për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj të njëpasnjëshëm. (Në tekstin e vendimit Nr. 302/2024, ERE shprehet: ... në pikën 12.1 (duhet të jetë 13.1) dhe 13.2 parashikohet ndryshimi i afatit si vijon: 13.2. *Palët kanë të drejtë të zgjidhin marrëveshjen në çdo kohë [] pengon palën e prekur që të përmbush detyrimet e kësaj marrëveshje për një periudhë 12 (dymbëdhjetë) muaj të njëpasnjëshëm. Nuk është e qartë nëse është lapsus material apo vendimmarrje e ERE -s dhe nëse afati duhet të ndryshojë dhe periudha 12 mujore duhet të vendoset edhe në pikën 13.1).*

13.3. Pala tjetër brenda një afati kohor prej 10 ditësh nga marrja e njoftimit duhet të ndreqë ose kompensojë shkeljen e pretenduar të detyrimit Kontraktor ose në rast të mospajtit lidhur me pretendimin do t'i shprehë Palës tjetër me shkrim këtë mospajtim duke përcaktuar në të edhe argumentimet e veta për këtë.

13.4. Në qoftë se brenda afatit 10 ditor si më sipër nuk është bërë ndreqja apo kompensimi i shkeljes Kontraktore ose Pala që ka bërë shkeljen nuk i ka shprehur Palës tjetër mospajtimin me shkrim brenda këtij afati, atëherë Pala që pretendon shkeljen mund të kërkojë zgjidhjen e njëanshme të Kontratës.

13.5. Palët do të kenë të drejtë të kërkojnë përfundimin e Kontratës në mënyrë të njëanshme në qoftë se ato nuk janë në gjendje të përmbushin detyrimet Kontraktore sipas kësaj Kontrate për një periudhë kohore pa ndërprerje më shumë se 6 muaj si rezultat i Forcës Madhore.

13.6. Palët kanë të drejtë të kërkojnë përfundimin e Kontratës kur:

- a) Njëra nga Palët falimenton ose nuk është në gjendje të paguajë borxhet ose dështon, ose pranon me shkrim paafësinë e saj të përgjithshme për të paguar borxhet kur duhet;
- b) Në rast se njëra nga Pala ka dhënë garanci jokorrekte dhe të pavërteta;
- c) Në rast të shkeljes nga ana e Palëve të rregullave dhe kërkesave teknike të parashikuara nga aktet nënligjore në fuqi.

13.7. Përfundimi i Kontratës sipas paragrafeve 13.4, 13.5, 13.6 të këtij neni bëhet me miratimin e ERE.

13.8 Palët do të llogarisin brenda 30 ditëve pune duke filluar nga dita e përfundimit të Kontratës, detyrimet financiare respektive dhe mënyrat e shlyerjes së tyre.

Miratur me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshuar me Vendimin nr.147 datë 30.09.2016 dhe Vendimin Nr.12, datë 23.01.2020.

15.1 Kjo Kontratë dispozitat e të cilës janë miratur nga ERE hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga Palët.

**Neni 16 (në kontratën ekzistuese është neni 17)
Ndryshimet**

16.1 Në qoftë se ndonjë term, kusht apo rregull i kësaj Kontrate do të bëhet i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm plotësisht apo deri në njëfarë mase, ky term, kusht apo rregull nuk do të sjellë pavlefshmërinë, paligjshmërinë apo pazbatueshmërinë e kushteve, termave dhe rregullave të parashikuar me pjesën tjetër të kësaj kontrate.

**Neni 17 (në kontratën ekzistuese është neni 18)
Legjislacioni**

17.1 Kontrata për shit-blerjen e Energjisë Elektrike do të bazohet dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 18 (në kontratën ekzistuese është neni 19)
Njoftimet**

18.1 Çdo njoftim i dhënë nga njëra Palë tjetrës sipas Kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në Kontratë.

1.8. Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 19 (në kontratën ekzistuese është neni 20)
Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

19.1 Në rast të mosmarrëveshjeve, Blerësi dhe Shitësi do të bëjnë fillimisht përpjekje të zgjidhin konfliktin me mirëkuptim. Nëse Palët nuk gjejnë mirëkuptim, ato mund të kërkojnë ndërhyrjen e ERE-s.

19.2 Palët në çdo rast kanë të drejtën e zgjidhjes së konfliktit në rrugë gjyqësore ose në arbitrazh sipas përcaktimeve të bera nga vetë Palët. Gjykata kompetente për zgjidhjen e